




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të përgjegjesive dhe kompetencave që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti Komunal dhe aktet e tjera nënligjore, Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të njoftimit të Menaxherit të njësisë së personelit të dt. 01.08.2011 për ndërprerjen e procedurës së rekrutimit, në mbështetje të nenit 22 pika 4 të Rregullores nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbyesve civil, mer këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e procedurës së rekrutimit

I.

Me këtë vendim, **Ndërprehet** procedura e rekrutimit sipas konkursit të publikuar në të perditshmen e pavarur informative "Epoka e Re" me **13.07.2011**, për pozitat: Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, Inspektor për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Drejtoria për administratë të përgjithëshme: Zyrtar i gjendjes civile, Drejtoria e financave: Zyrtar për PPP dhe Zyrtar për zhvillim ekonomik, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari: Shef i sektorit të pylltaris dhe Roje pyelli 3 (tre) egzekutues.

II.

Ndërprerja e procedurës së rekrutimit bëhet për shkak se numri i aplikacioneve të pranuar për këto pozita është më i vogël se 5 (pesë) dhe se nuk ka balance etnik dhe gjinor.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Njësia e personelit e cila obligohet që për pozitat e ndërprera të procedurës së rekrutimit ta **Rishpall konkursin përveç pozitës së Zyrtarit për PPP.**

IV.

Ky vendim hynë në fuqi nga data e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

V.

Vendimi të publikohet në tabelen e shpalljeve të Komunës



Kryetari i Komunës

/Qemal Mustafa/